



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-040
Prishtinë, më 20 tetor 2015
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Formimi i grupeve të miqësisë,
2. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
3. Kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për rinovimin e sheshit “Adem Jashari”
4. Procedimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës,
5. Çështja e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës,
6. Propozim-vendimi për shpalljen e konkursit për anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave,
7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Parlamentin e Rumanisë prej 21-24 tetor 2015.

* * *

1. Formimi i grupeve të miqësisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se në mbledhjen e Kryesisë, të mbajtur më 14 shtator 2015, është shqyrtuar propozimi për formimin e grupeve të miqësisë dhe në parim janë miratuar kriteret për ndarjen e tyre sipas grupeve parlamentare të Kuvendit.

Ai e hapi diskutimin lidhur me formimin grupeve të miqësisë.

Për këtë çështje diskutuan: nënkryetarët e Kuvendit Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Duda Balje dhe Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia i autorizoi nënkryetarët e Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti, që të bëjnë ndarjen e grupeve të miqësisë sipas grupeve parlamentare dhe në secilin grup të miqësisë të mos jenë më pak se pesë anëtarë.

Pas një pauze, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti i informoi në hollësi anëtarët e Kryesisë me propozimin për formimin e 46 grupeve të miqësisë.

Në fund, Kryesia vendosi që të formohen 46 grupe të miqësisë, si dhe i caktoi kryesuesit e tyre sipas fuqisë politike që kanë grupet parlamentare në Kuvend, si në vijim:

- Grupi i Miqësisë me Spanjën, Partia Demokratike e Kosovës;
- Grupi i Miqësisë me Rumaninë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
- Grupi i Miqësisë me Qipron, “Nisma”;
- Grupi i Miqësisë me Sllovakinë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës;
- Grupi i Miqësisë me Greqinë, Partia Demokratike e Kosovës;
- Grupi i Miqësisë me Holandën, Partia Demokratike e Kosovës;

Grupi i Miqësisë me Belgjikën, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Italinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Vatikanin, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Maltën, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Lituaninë dhe Letoninë, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Estonin, Lista serbe;
 Grupi i Miqësisë me Poloninë, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Hungarinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Egjiptin, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Arabinë Saudite, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Emiratet e Bashkuara Arabe, “Vetëvendosje”;
 Grupi i Miqësisë me Katarin, “Vetëvendosje”;
 Grupi i Miqësisë me Kuvajtin, “Nisma”;
 Grupi i Miqësisë me Britaninë e Madhe, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Irlandën, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Danimarkën, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Suedinë, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Finlandën, “Vetëvendosje”;
 Grupi i Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Kroacinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Gjermaninë, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Shqipërinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Slloveninë, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Austrinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Zvicrën, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Turqinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Francën, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Japoninë, Partia Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Australinë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Zelandën e Re, “Vetëvendosje”;
 Grupi i Miqësisë me Malin e Zi, “Vetëvendosje”;
 Grupi i Miqësisë me Maqedoninë, “6+”;
 Grupi i Miqësisë me Kanadanë, Lidhja Demokratike e Kosovës;
 Grupi i Miqësisë me Malajzinë, “6+”;
 Grupi i Miqësisë me Bullgarinë, “Nisma”;
 Grupi i Miqësisë me Ganën, Lista serbe;
 Grupi i Miqësisë me Portugalinë, Partia Demokratike e Kosovës; dhe
 Grupi i Miqësisë me Tunizinë, “Vetëvendosje”.

Kryetarja e Grupit Parlamentar “6+”, Müfera Şinik kërkoi që kryesuesi i Grupit të Miqësisë me Republikën e Turqisë të jetë nga ky grup. Kryesia nuk e mbështeti këtë kërkesë me arsyetimin se raportet ndërshtetërore nuk ndërtohen në bazë të parimit etnik, ndërsa Grupit Parlamentar “6+” i takon kryesimi i dy grupeve të miqësisë me parlamentet e shteteve tjera.

Gjithashtu, Kryesia konstatoi se grupet parlamentare duhet t’i caktojnë emrat e deputetëve për kryetar dhe zëvendëskryetar të grupeve të miqësisë, sipas kritereve të shënuara më lart.

2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari e ftoi sekretarin e Kuvendit që ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit lidhur me këtë pikë.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, e paraqiti propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, propozoi që pika II e propozimit që Njësia për Legjislacion dhe Përafrim për plotësimin edhe me gjashtë (6) zyrtarë të lartë për legjislacion të shtyhet me arsyetimin se duhet konsultuar Fakultetin Juridik të UP-së për mundësinë e shfrytëzimit të ekspertizës së tyre gjatë shqyrtimit të projektligjeve në procedurat parlamentare.

Kryetari e hodhi në votim propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, pa pikën II.

Kryesia njëzëri mori këtë:

Vendim

1. Miratohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-V-396, datë 5 shtator 2013.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

3. Kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për rinovimin e sheshit “Adem Jashari”

Kryesia e shtyu kërkesën e lartshënuar për shqyrtim për mbledhjen e rashës të Kryesisë me arsyetimin që kërkesa të plotësohet edhe me materialin tjetër të dërguar nga Komuna e Prishtinës lidhur me projektin që do të zbatohet për rinovimin e sheshit “Adem Jashari”.

4. Procedimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, diskutuan: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohej nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit që ta rishqyrtojë tekstin e Projektligjit

Binjakëzimit, i financuar nga Bashkimi Evropian.

5. Çështja e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që për mbarëvajtjen e transmetuesit publik të bëjë një zgjidhje të përkohshme për financimin e Radiotelevizionit të Kosovës për vitin fiskal 2016.
2. Në të njëjtën kohë duhet intensifikuar punën që paralelisht me Ligjin për RTK-në të gjenden edhe modalitetet e financimit afatgjatë të RTK-së.

6. Propozim-vendimi për shpalljen e konkursit për anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave ta shpallë konkursin për tre (3) anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave.

7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Parlamentin e Rumanisë prej 21-24 tetor 2015

Kryesia nuk e miratoi kërkesën e lartshënuar.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 12:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale